

PROTOKOLLI

PËR ZBATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT KËRKIMOR-
SHKENCOR DHE ARTISTIK NDËRMJET AKADEMISË SË SHKENCAVE TË
SHQIPËRISË DHE AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË
KOSOVËS

Akademia e Shkencave e Shqipërisë (në vazhdim: ASHSH) dhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (në vazhdim: ASHAK) në zbatim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit Kërkimor-Shkencor dhe Artistik të vitit 2000, për vitet 2013-2015, ranë dakord të zhvillojnë këto veprimtari të përbashkëta:

1. **Çështje të standardizimit të shqipes dhe të terminologjisë - veprimtari e Këshillit Ndërakademik të gjuhës shqipe.** Bashkëpunim i vazhdueshëm midis ASHAK (SGJL) dhe -ASHSH (SSHSHA, IGJL - QSA);

2. Konferencë shkencore ndërkombëtare **F. S. Noli - gjeniu i kulturës shqiptare të shekullit XX** (Me rastin e 50-vjetorit të vdekjes) - Tiranë, 2015;

3. **Konferencë shkencore për studimet albanologjike**, ASHAK (SGJL) në bashkëpunim me ASHSH (SSHSHA, QSA), Prishtinë 2014;

4. Konferencë shkencore **Lufta e Parë Botërore 1914 dhe çështja shqiptare**, ASHAK (SSHSH, IHP) në bashkëpunim me ASHSH, Prishtinë 2014;

5. Tryezë shkencore **Arkeologjia në trojet shqiptare-sfidat dhe mundësitë**, ASHAK-ASHSH, Prishtinë 2014;

6. Projekt: **Klima dhe parametrat projektues për qytetet kryesore të Kosovës dhe të Shqipërisë**, ASHAK (SSHN) dhe ASHSH (SSHNT, INEUM - UPT), 2013 e në vazhdim;

7. Hartimi i monografisë **"Prodhimi cilësor i fidanëve të pemëve frutore, hardhisë, ullirit dhe agrumeve"** bazuar në studimin e Projektit: **"Inventarizimi i virozave dhe shëndetësimi i materialit mbjellës të specieve frutore dhe vreshtave në Kosovë dhe Shqipëri"** (2009 – 2013) ASHSH (SSHNT; FSHN - UT; UBT; QTTB, Vlorë, MBUMK) dhe ASHAK (SShN), 2013 e në vazhdim. (Botimi do të realizohet nga ASHSH).

8. **Promovime veprash shkencore**, ASHAK dhe ASHSH, 2013 e në vazhdim;

9. **Shkëmbime reciproke të periodikëve dhe botimeve shkencore**, ASHAK dhe ASHSH, 2013 e në vazhdim;

10. **Ligjërata të ndërsjella të akademikëve**, ASHAK dhe ASHSH, 2013 e në vazhdim.

Për secilën prej veprimtarive të mësipërme do të hartohen programe të posaçme pune të miratuara nga organet përkatëse të institucioneve bashkëpunuese.

Për të ndjekur ecurinë e realizimit të veprimtarive të parashikuara në këtë Protokoll, përfaqësues të dy palëve do të takohen të paktën një herë në vit. Vendi dhe data e takimit do të caktohen me korrespondencë.

Ky Protokoll mund të ndryshohet me miratimin e të dy palëve, në varësi të prioriteteve të kohës dhe të sigurimit të burimeve financiare.

Protokolli është i vlefshëm për një periudhë dyvjeçare që nga data e nënshkrimit.



Nënshkruar në Tiranë, më 13 qershor 2013, në dy kopje, me përmbajtje dhe vlerë të njëjtë.

PËR AKADEMINË E SHKENCAVE
TË SHQIPËRISË

PËR AKADEMINË E SHKENCAVE DHE TË
ARTEVE TË KOSOVËS

AKADEMIK SALVATOR BUSHATI

AKADEMIK ISUF KRASNIQI



Tiranë, më 13 qershor 2013